

MALI I ZI



GJYKATA THEMELORE NË
ULQIN



TRASHËGIMIA

Kur një person i cili është rezident në zonën e Komunës së Ulqinit ka vdekur, Gjykata Themelore në Ulqin, verifikon se cilët janë trashëgimtarët e të ndjerit, çka e përbën pasurinë trashëgimtare të tij dhe çfarë të drejtash i takojnë trashëgimtarëve të tij, legëve dhe personave tjerë. Gjykata Themelore në Ulqin drejton procedurën nëse i ndjeri kishte vendbanimin ose vendqëndrimin në territorin e komunës së Ulqinit. Nëse në kohën e vdekjes i ndjeri nuk kishte një qëndrim të përhershëm ose qëndrim të përkohshëm në territorin e Malit të Zi, kompetente është gjykata në territorin e së cilës gjendet pjesa më e madhe e trashëgimisë së tij.

SI TË NISËT PROCEDURA

Pas vdekjes së trashëgimlënësit:

1. Ju duhet të kontaktoni Departamentin e punëve administrative pranë MPB Ulqin. Punonjësi do të jua kërkoj informacionet në lidhje me të vdekurin, në lidhje me të afërmit e tij, egzistimin e testamentit, dhe për vlerëne përafërt të pasurisë që la personi i vdekur.
2. Pas kësaj, departamenti kompetent i këtij organi, do të lëshoj një certifikatë vdekje, e cila duhet të dorëzohet pranë Gjykatës Themelore në Ulqin - me Propozimin për nisjen e procedurës për shqyrtimin e trashëgimisë, në të cilën do të specifikohet se cilët janë trashëgimtarët, adresa etyre e saktë, çfarë paraqet pasuria të cilën e la i ndjeri, si dhe çdo informacion tjetër i nevojshëm që Gjykata të veproj mbi propozimin.
3. Gjykata pastaj do të caktojë një seancë në të cilën do të ftojë të gjitha palët e interesuara, pikërisht në adresat e dhëna në certifikatën e vdekjes.

PAS MBËRRITJES NË SEANCË NË GJYKATË DUHET TË:

1. Sillni kartën tuaj të identitetit ose pasaportën;
2. Të sillni testamentin e të ndjerit në rast se egziston;
3. Sillni provat mbi pasurinë e trashëgimlënësit:
 - a. Në rast se bëhet fjalë për patundshmëri është e nevojshme për të marrë një fletë - pronësi, jo më të vjetër se 6 muaj;
 - b. Në rast se bëhet fjalë për pasuri të luajtshme duhet të silllet psh. për automjetin leja e qarkullimit, në qoftë se ekziston një llogari bankare duhet të silllet librezja e kursimeve, një certifikatë etj.

GJATË PROCEDURËS

Gjykata Themelore në Ulqin do të përcaktojë trashëgimtarët dhe do të aprovon Aktvendimin mbi trashëgimi.

Pas përfundimit të procedurës, gjykata do të vendos mbi taksat që trashëgimtarët janë të detyruar t'i paguajnë.

Kjo tarifë është përcaktuar nga vlera e pasurisë së trashëgimlënësit, dhe trashëgimtarët e paguajnë krahas përqindjes së trashëguar. Informacionet shitesë mund të merren nga të punësuarit në regjistrin e Gjykatës ose në këto numra telefoni 030/410-250 ose 412-026.

GJYKATA THEMELORE NË ULQIN

Adresa: rr. Boshko Strugar, Ulqin,
Mali i Zi

Tel. 030/412 026, 412 071,

Faks. 030/421 251

Web faqja e gjykatës:

<http://sudovi.me/osul>

Orari i punës së Gjykatës:

E hënë - E premte

ora 08,00-16,00

Orari i punës së regjistrit të Gjykatës

E hënë - E premte

ora 11,00-14,30



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

Ky doracak është realizuar me mbështetjen e popullit amerikan, nëpërmjet Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar, Programi i menaxhimit efikasë në Mal të Zi.

E drejta e autorit në imazhet: Studio Mouse, Podgoricë.
Përgatitja dhe printimi: Studio Mouse

Ky doracak ka për qëllim të ofrojë informacione bazë mbi procedurën në fjalë para gjykatës. Ky nuk mund të shërbejë si një zëvendësim për këshilla profesionale ligjore.

Gjithashtu, për shkak të ndryshimit të legjislativës, mund të ndodhë, që përmbajtja e broshurës nuk është plotësisht në përputhje me rregulloren aktualisht në fuqi.